



Pranuar / Dorezuar Prijmljena/Prudato Received/Delivery	29.01.2021	1	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHCK	353/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.425/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.425/2020 të datës 18.12.2020, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat me adresë Rr.“Sylejman Vokshi”, H19, Nr. 4, Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.425/2020 të datës 18.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.ref:125/2020 i datës 30.03.2020 si dhe Vendimi me Nr.ref:629/2020 i datës 28.08.2020 lidhur me pjesën e mbetjes në fuqi të Vendimit me numër Nr.125/2020 të datës 30.03.2020, të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 18.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3194/2020, të regjistruar me numër A.nr.425/2020, kundër shkresës zyrtare/njoftimit të datës 23.11.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilin është shpallur jo kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil A.nr.259/2020 të datës 02.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën Anr.425/2020 me numër protokollit 3194/2020 të datës 18.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 23.11.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesën Anr.259/2020 me numër protokollit 1696/2020 të datës 04.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Anr.259/2020 nr. protokollit 2394/2020 i datës 02.11.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin nr.ref.629/2020 të datës 28.08.2020; Vendimin nr.ref.125/2020 të datës 30.03.2020; Vendimin Nr.198/2020 të datës 13.05.2020; Vendimin e vitit 2012; Vendimin e datës 22.03.2016 nr.ref.104/2016; Dëshminë e dokumenteve të dorëzuara e datës 19.08.2011; E-mail i datës 28.01.2012; E-mail i datës 01.02.2012; Note verbale e datës 06.07.2018 numër Ref: ZDP/112/2018; Autorizimin e datës 14.12.2020; E-mail i datës 12.02.2012; Kërkesë drejtuar Zyrës së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2020; Flete kthesën e datës 16.09.2020; Njoftimin e datës 17.07.2020 nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 19.06.2020; E-mailin i datës 03.02.2012; Kërkesën për shtyrje të afatit e datës 16.10.2020; Kërkesën e datës 15.10.2020 për plotësim të lëndës; Përgjigjen e datës 18.10.2020 në kërkesë, E-mailin e datës 31.03.2020 dhe i datës 31.03.2020, E-mail /Njoftim i datës 17.07.2020, E-mail i datës 02.11.2020; Ftesën për seancë dëgjimore e datës 1901.2021, E-mailin i datës 19.01.2021; Email i datës 21.01.2021; Procesverbal i datës 25.01.2021 mbi seancën dëgjimore; Kërkesën e datës 26.01.2021 për prova shtesë; Përgjigjen e datës 27.01.2021 në kërkesë; E-mailin e datës 27.01.2021; Vendimi nnr.140/11 i datës 21.07.2011 për shpallje të konkursit; Konkursin e datës 22.07.2011; Listën e kandidatëve-aplikuar për misione konsullore, gusht 2011; Listën e kandidatëve-aplikuar për misione diplomatike, gusht 2011; Vendimin Nr.132/2017 të datës 19.09.2017.

Kolegji pas seancës dëgjimore të datës 25.01.2021 dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.425/2020 e datës 18.12.2020, e parashtruar nga *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e tij të precizuar në seancën dëgjimore me datë 25.01.2021, pretendon se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPJD-së, me refuzimin e shqyrtimit të ankesës nr. protokollit 1025 të datës 19.06.2020, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin 03-L-122 për Shërbimin e Jashtëm si dhe Ligjin Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe Shërbimin Diplomatik. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën, të anuloj vendimin Nr. 125/2020 të datës 30.03.2020 lidhur me përfundimin e mandatit të ankuesit si Sekretar i Parë në Riad, si dhe paragrafin 2 të Vendimit Nr.ref. 629/2020 të datës 28.08.2020 lidhur me mbetjen në fuqi të vendimit Nr. 125/2020 të datës 30.03.2020, të detyroj Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të kompensoj të ardhurat personale të pa realizuar për periudhën nga 13.11.2012 deri me 01.04.2016 si dhe nga data 15.09.2020 deri në sistemin e tij në ndonjë pozitë të lirë duke marrë parasysh përvojën dhe kualifikimet e ankuesit.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka gjetur se ankuesi me Vendimin Nr.104/2016 të datës 22.03.2016, të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është emëruar "Sekretar i Parë" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Riad/Arabi Saudite. Ndërsa me datë 30.03.2020, Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Vendimit me numër Nr. 125/2020 të datës 30.03.2020, ankuesit i ka përfunduar mandatin e Sekretarit të Parë në Riad, me datë 30.06.2020, me arsyetimin se emërimi i ankuesit nuk është bërë sipas procedurave të pranimit në Shërbimin e Jashtëm të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-122 për Shërbim të Jashtëm si dhe Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë.

Për shkak të situatës së pandemisë më Covid-19, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me

Vendimin me Nr.198/2020 të datës 13.05.2020, ka shtyrë ekzekutimin e vendimeve që i referohen tërheqjes së diplomatëve nga misionet diplomatike apo postet konsullore, deri me 30.08.2020, duke përfshirë edhe Vendimin Nr. Ref. 125/2020 të datës 30.03.2020 lidhur me përfundimin e mandatit të ankuesit si Sekretar i Parë i Ambasadës së Kosovës në Riad.

Kundër Vendimit me Nr.125/2020 të datës 30.03.2020 dhe Vendimit Nr.198/2020 të datës 13.05.2020, të Ministrisë të MPJD, ankuesi me datë 19.06.2020 ka ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPJD, ndërsa ky i fundit përmes shkresës zyrtare të datës 17.07.2020, ka njoftuar ankuesin se nuk ka kompetencë lëndore të shqyrtoj ankesën e tij.

Me datë 28.08.2020, Ministria e MPJD-së me Vendimin Nr.Ref.629/2020, ka shfuqizuar pezullim e vendimeve Nr.ref:121/2020, Nr.ref:122/2020, Nr.ref:124/2020, dhe vendimin Nr.ref:125/2020 të datës 30.03.2020 lidhur me përfundimin e mandatit të ankuesit si Sekretar i Parë në Riad, duke lënë në fuqi këto vendime si dhe ka përcaktuar kthimin nga misioni diplomatik me datë 15.09.2020, pa ndonjë obligim të MPJD-së për sistemimin e tyre në shërbimin e jashtëm. Kundër këtij vendimi, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1696/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Pas shqyrtimit të ankesës Këshilli ka konstatuar se KZKA-ja ka kompetencë lëndore, andaj me Vendimin A.Nr.259/2020 të datës 02.11.2020 ka detyruar Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPJD-së, që të bëjë shqyrtimin e ankesës me numër protokolli 1025 të datës 19.06.2020, të parashtruar nga ankuesi si dhe të gjitha pretendimet tjera të mëvonshme të cilat ndërlidhen më këtë lëndë.

Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPJD-së, me njoftimin e datës 23.11.2020, serish është shpallur jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesit. Pas njoftimit të KZKA-së, të datës 23.11.2020, ankuesi me datë 18.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Ankuesi në ankesën e tij dhe në seancën dëgjimore të datës 25.01.2021, deklaron se ka respektuar dhe i është nënshtruar të gjitha procedurave të rekrutimit për pozitën "Drejtues apo nëpunës tjerë në mision konsullor/diplomatik" i shpallur nga MPJ-ja në vitin 2011. Me tutje ankuesi deklaron se: Kam qenë në dijeni sipas disa informatave brenda MPJ-së, se ministri i atëhershëm me datë 13.12.2012 kishte nxjerrë vendim për emërimin tim Zëvendës Konsull i Përgjithshëm në Strasburg të Francës, por që ky vendim asnjëherë nuk më është dorëzuar, dhe pas 40 muajve respektivisht me datë 22.03.2016 më është lëshuar Vendimi Nr.104/2016 për emërimin tim në pozitën e Sekretarit të Parë, të Ambasadës së Kosovës në Riad / Arabisë Saudite.

Ndërsa organi i punësimit në përgjigjen në ankesë dhe në seancën dëgjimore të datës 25.01.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar z. deklaron se lidhur me procedurën e rekrutimit në të cilën ka aplikuar ankuesi, posedojmë shkresa vetëm për pjesëmarrje të ankuesit në testin me shkrim dhe në testin e gjuhës angleze dhe gjermane. Pas kësaj faze nuk ekziston ndonjë dokument për përzgjedhjen e ankuesit në këtë pozitë apo ndonjë akt mbi themelimin e marrëdhënies së punës së ankuesit me MPJD-ën. Me tutje deklaron se çdo pranim në shërbim të jashtëm, behët vetëm pasi janë zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas Ligjit për Shërbimin Civil dhe pas procedurës së gradimit nga Komisioni për Disiplinë dhe Gradime në kuadër të MPJD-së, në pajtim me legjislacionin për shërbim të jashtëm, e të cilat procedura nuk janë respektuar me rastin e emërimit të ankuesit si Sekretar i Parë i Ambasadës së Kosovës në Riad.

Lidhur me pretendimet ankimore te ankuesit, Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë, si ligj i aplikueshëm në kohën kur ankuesi është emëruar Sekretari i Parë në Ambasadën e Kosovës në Riad, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me Nr.ref:AGJ 1583/2020, si dhe Legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës përkatësisht Ligjin Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, Ligjin Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, Rregulloren Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm dhe aktet tjera nënligjore për shërbim të jashtëm dhe diplomatik.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, respektivisht nenin 3 i cili përcakton se: *Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi* si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, nenin 8 ku përcaktohet se: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovë, Kolegji për Shqyrtim e Ankesës ka konstatuar se nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm përjashtimisht të emëruarve politikë, kanë statusin e nëpunësit civilë, dhe të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit të aplikueshëm për shërbimin civil, përveç nëse përshihet ndryshe me legjislacionin e veçantë të MPJD-së.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, si dhe deklaratimet e palëve në seancë dëgjimore, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka aplikuar me datë 19.08.2011 në konkursin publik të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtëm me datën 22.07.2011 për pozitën "drejtues dhe nëpunës tjetër konsullor/diplomatik". Sipas shkresave të lëndës ankuesi është ftuar dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim nga fusha e diplomacisë me datë 04.02.2012, testin e gjuhës angleze me datë 08.02.2012 si dhe testin për gjuhë gjermane me datë 12.02.2012. Përveç këtyre veprimeve në shkresat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur asnjë veprim tjetër procedural të zhvilluar nga organi i punësimit lidhur me këtë procedurë rekrutimi, duke përfshirë edhe dëshmitë lidhur me përzgjedhjen e ankuesit si kandidat të suksesshëm, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Andaj, bazuar në këto fakte, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtroar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore, si dhe nenin 19 paragrafi 1 ku përcaktohet se: Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me asnjë provë nuk ka dëshmuar se i njëjti i është nënshtroar procedurës së gradimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 28 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, ku parashihet se: *Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet*

kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës.

Andaj mbi këtë bazë, rrjedhë se Vendimi me Nr.ref:125/2020 i datës 30.03.2020 si dhe Vendimi me Nr.ref:629/2020 i datës 28.08.2020 lidhur me pjesën e mbetjes në fuqi të Vendimit me numër Nr.125/2020 të datës 30.03.2020, të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë ligjërisht të bazuara dhe se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk mbanë detyrim ligjor për sistemimin e ankuesit pas përfundimit të mandatit të tij si Sekretar i Parë si dhe kompensimin e të ardhurave për periudhat e cekura në ankesë.

Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nënin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 si dhe nënin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.425/2020

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

